



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.115/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.03.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-49029-02-04-2020, me objekt “*Blerje Mjete transporti dhe agregat*”, me fond limit 12 500 000 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 28.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

Ankimues: “Luar Bros” shpk
Blv “Gjergj Fishta”, Qendra Alpas, Shk.2, Kati.2, Ap.1
Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit
Rruga 5 Maji

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.02.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-49029-02-04-2020, me objekt “*Blerje Mjete transporti dhe agregat*”, me fond limit 12 500 000 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 28.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

II.2. Në datën 11.02.2020 operatori ekonomik “Luar Bros” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- *Pasi u njohëm me kërkesat e kësaj procedure prokurimi konstatojmë se ato bien ndesh me legjislacionin në fuqi dhe parashtrojmë këtë ankesë.*

- *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar ing Mekanik staf teknik, te përfshirë në licencën e shoqërisë së paisur me dëshmi aftësi profesionale leshuar nga Ministria e Transportit dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për periudhën Gusht 2019-Janar 2020 për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listat e shoqërisë, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur.*
- *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht, 1(një) Automakinist, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), leshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për periudhën Gusht 2019-Janar 2020.*
- *Operatori ekonomik duhet të ketë marrëveshje ose kontrate me shitësin ose distributorin të autorizuar të shoqëruar me specifikime teknike të mjeteve dhe Foto, në rast se kontrata ose marrëveshja është me shitës ose distributore të huaj duhet të jetë e përthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Automjetet duhet të jenë të prodhuara në Komunitetin Europian.*
- *Operatori Ekonomik duhet të disponojë ose të paraqesë kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të repartëve të punës.*
- *Lidhur me kriterin Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar ing Mekanik staf teknik, te përfshirë në licencën e shoqërisë së paisur me dëshmi aftësi profesionale leshuar nga Ministria e Transportit dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për periudhën Gusht 2019-Janar 2020 për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listat e shoqërisë, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur, bie ndesh me nenin 6 dhe 12 të Ligjit nr.9573 datë 03.07.2006 "Për Autoriparimi". Neni 4 parashikon se Ushtrimi i veprimtarisë së autoriparimit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, u lejohet vetëm subjekteve, që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji.*
Neni 6 pika 2 parashikon se: 2. Subjektet, që kërkojnë të regjistrohen në regjistër, duhet të kenë detyrimisht një përgjegjës teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti. Përgjegjësi teknik mund të jetë edhe drejtuesi ekzekutiv i subjektit.
Neni 9 parashikon se: 1. Përgjegjësi teknik, i përcaktuar në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji, duhet të plotësojë këto kërkesa: a) të mos jetë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji; b) të ketë aftësi fizike për të kryer këtë veprimtari, të vërtetuar nga organi shëndetësor përkatës, brenda juridiksionit ku banon. 2. Përgjegjësi teknik pajiset me "Dëshmi aftësie profesionale" nga Drejtoria e

Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi të ketë kaluar provimin për nivelin e njohurive, të cilat përcaktohen në udhëzimin e ministrit që mbulon fushën e transportit.

Neni 12 parashikon qartë: Veprimtaria e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, u lejohe vetëm subjekteve juridike, të regjistruara në seksionin përkatës të regjistrit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar nga ana jonë legjislatore njehe përgjegjës teknik vetëm për subjektet tregëtare që ushtrojnë veprimtari autoriparimi shif referencat neni 4-9. Pra ligji neni 4,6,9 sanksionojnë qartë se subjektet tregëtare që ushtrojnë veprimtari autoriparimi duhet të kenë përgjegjës teknik dhe në asnjë rast nuk këkrohet që përgjegjësi teknik të jetë pjesë e licencës së kompanisë. Përkundrazi lejohe që përgjegjësi teknik të jetë edhe drejtues i kompanisë. Ndërsa për subjektet që tregëtojnë produkte pra mjete ato nuk parashikohen në ligjin e posacëm sectorial të kenë përgjegjës teknik dhe për më tepër që të kenë drejtues teknik sikundër e kërkon AK dhe jo më të ketë drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

Pra AK me veprime konkludente të drejtpërdrejta ka tejkaluar diskrecionin dhe ka ushtruar në mënyrë disproporcionale çfardo nevojë të diktojnë llojin e kontratës. Pra AK kërkon mjete dhe nuk ka parashikuar në DT asnjë aktivitet shërbimi. Madje edhe periudha e garancisë është aq minimaliste saqë nuk ka nevojë për shërbim mirëmbajtje. Pra periudha 3 mujore është e papërfillshme me çfardolloy nevojë ti dalë AK në zbatimin e kontratës. Referuar praktikave tregëtare në vendin tonë madje edhe sipas të dhënave të vetë INSTAT njësitë ekonomike që tregëtojnë mjete janë vecmas nga ato të autoriparimit pasi kanë të bëjnë me aktivitete tregëtare tërësisht të ndryshme në formë dhe në përmbajtje.

Kërkojmë nga AK të heqë këtë kërkesë ose të riformulojë sa më pranë kushteve të tregut kërkesën dhe të heqë automatikisht kërkesën që subjekti të ketë përgjegjës mekanik apo teknik të regjistruar në licencën e kompanisë. Neni 6 parashikon dokumentacionin që duhet të ketë përgjegjësi teknik si kontrata e punës dëshmia apo diploma.

- *Në lidhje me kërkesën e AK: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht, 1(një) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për periudhen Gusht 2019-Janar 2020.*

Vlerësojmë se kjo kërkesë nuk ka asnjë bazë me kërkesat e AK në DT si dhe neni 12 të ligjit të sipërcituar. Kërkesa është disproporcionale dhe nuk ka lidhje me objektin e kontratës, kjo për faktin se automakinisti është manovrator dhe AK nuk ka kërkuar shërbim automekanik, por ka kërkuar blerjen e një mjeti motorrik. AK nuk ka parashikuar asnjë shërbim që lidhet me automekanikën duke e bërë këtë kërkesë të ekzagjeruar, irracionale dhe të paligjshme. Ajo bie ndesh me nene të ligjit për autoriparimin, shitblerjen e mjeteve motorrike, e cila parashikon disa kategori të

ndryshme subjektesh që operojnë në fushën e autoriparimit, tregëtimit, ndërmjetësimit të mjeteve të reja e të përdorura dhe nuk parashikon në asnjë moment që subjekti tregëtar të ketë cdo lloj punonjësi teknik. Pra shitblerja ndryshon nga shërbimet por AK duhet të sensibilizohet të jetë më i ligjshëm në veprimtarinë e tij administrative. Ndaj sa më sipër kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

- *Në lidhje me kriterin: Operatori ekonomik duhet të ketë marrëveshje ose kontrate me shitesin ose distributorin të Autorizuar të shoqëruar me specifikime teknike të mjeteve dhe Foto, në rast se kontrata ose marrëveshja është me shites ose distributore të huaj duhet të jetë e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Automjetet duhet të jenë të prodhuara në Komunitetin Europian.*

Kërkojmë riformulimin e tij pasi kjo kërkesë nuk mban parasysh të drejtën e ndërmjetësve për të ofruar shërbime referuar nën 14 të këtij ligji. Pika 3 e nenit 14 sanksionon vetëm këtë kërkesë në lidhje me subjektet ndërmjetësuese. Subjektet e lartpërmendura duhet të mbajnë në mjediset ku ushtrojnë veprimtarinë, në vende të dukshme, tabelat e veprimeve që kryejnë, si dhe tarifatat përkatëse për çdo ndërhyrje të bërë. Në të kundërt u nënshtrohen sanksioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

Pra sic del qartë referuar kërkesave të këtij ligji subjektet që merren me shitblerje apo ndërmjetësim nuk kanë asnjë detyrim por trajtohen vecmas nga entet ekonomike të autoriparimit. Ndaj tyre nuk parashikohet asnjë kërkesë apo staf teknik përveç detyrimeve administrative për mirëmbajtjen e të dhënave regjistruar etj.

Kjo kërkesë vjen në kontratë me kërkesën e pikës 1 të KVK e cila kërkon: Operatori ekonomik duhet të deklarojë llojin e mjeteve, të shoqëruara me librezën përkatëse dhe me foto për secilin, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjeteve me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen edhe kilometrat e bëra për çdo mjet, të shoqëruar edhe me foto të treguesit të kilometrazhit në kroskot për secilin prej tyre.

Vjen në kontratë pasi disa subjekte mund të zotërojnë mjetet dhe ato nuk parashikohen në këtë kërkesë. Vjen në kontratë me kërkesën e AK që OE të paraqesin ofertë për mjetin shoqëruar me librezën si dhe me deklaratë garancie. Pra nuk krijohet lidhja logjike dhe ligjore ndërmjet posedimit të sendit dhe posedimit të dokumentave. Ndërkohë ndërmjetesi mund të posedojë proformat që janë parakontrata me faturë parapagese dhe nuk posedojnë dokumenta të tjera dhe operojnë në përputhje me nenin 14 të këtij ligji. Pra AK e ka kufizuar veprimtarinë e OE garues vetëm tek operatorët e autoriparimit dhe kanë lënë jashtë shitblerjen dhe negocimin pra OE që shesin dhe ndërmjetësojnë shitblerjen e tyre. Në asnjë rast ligji nuk e kushtëzon veprimtarinë e tyre me autorizim prodhuesi apo kontratë.

Ndërkohë incotermat parshikojnë proforman si kontratë të llojit CNF. Referuar incotermave të ndërkombëtare të tregëtisë proforma:

A proforma invoice help tighten the export sale. Here are some ways in which a proforma invoice :

Minimizes errors;

Serves as a legal binding agreement;

Outlines all relevant information pertaining to the export transaction;

Is a widely accepted form of sales document structure in the export industry,

Enables banks to establish a payment method on behalf of the importer

Pra shërben si një dokument ligjor i detyrueshëm. Pra kërkojmë që AK të riformulojë kërkesën duke lejuar apo ripërkufizuar kërkesën për kontratën me termin dokument ligjor detyrues sipas incotermave. Kujtojmë në DT kanë cdo referencë tek incotermat dhe rrjedhimisht referenca që ne kërkojmë ka bazë ligjore dhe administrative të konsoliduar tashmë.

Për sa më sipër kërkojmë shqyrtimin dhe pranimin e kërkesave /ankesave tona.

II.3. Me shkresën nr.350/2 prot datë 13.02.2020 , autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.4. Në datën 24.02.2020 pala ankimuese “Luar Bros” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.1064/2 prot., datë 05.03.2020 protokolluar me tonën me nr.217/2 datë 06.03.2020 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se autoriteti kontraktor më datë 28.02.2020 ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi konkretisht me hapjen dhe vlerësimin e ofertave.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Luar Bros” shpk për modifikimin e kriterit “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar ing Mekanik staf teknik, te përfshire ne licensen e shoqërisë i paisur me deshmi aftesi

profesionale leshuar nga Ministria Transportit dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhen Gusht 2019-Janar 2020 për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listëpagesat e shoqërisë, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur, bie ndesh me nenin 6 dhe 12 të Ligjit nr.9573 datë 03.07.2006 "Për Autoriparimi".

Neni 4 parshikon se Ushtrimi i veprimtarisë së autoriparimit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, u lejonet vetëm subjekteve, që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji.

Neni 6 pika 2 parashikon se: 2. Subjektet, që kërkojnë të regjistrohen në regjistër, duhet të kenë detyrimisht një përgjegjës teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti. Përgjegjësi teknik mund të jetë edhe drejtuesi ekzekutiv i subjektit.

Neni 9 parshikon se: 1. Përgjegjësi teknik, i përcaktuar në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji, duhet të plotësojë këto kërkesa: a) të mos jetë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji; b) të ketë aftësi fizike për të kryer këtë veprimtari, të vërtetuar nga organi shëndetësor përkatës, brenda juridiksionit ku banon. 2. Përgjegjësi teknik pajiset me "Dëshmi aftësie profesionale" nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi të ketë kaluar provimin për nivelin e njohurive, të cilat përcaktohen në udhëzimin e ministrit që mbulon fushën e transportit.

Neni 12 parashikon qartë: Veprimtaria e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, u lejonet vetëm subjekteve juridike, të regjistruara në seksionin përkatës të regjistrimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar nga ana jonë legjislacioni njeh përgjegjës teknik vetëm për subjektet tregëtare që ushtrojnë veprimtari autoriparimi shif referencat neni 4-9. Pra ligji neni 4,6,9 sanksionojnë qartë se subjektet tregëtare që ushtrojnë veprimtari autoriparimi duhet të kenë përgjegjës teknik dhe në asnjë rast nuk kërkohet që përgjegjësi teknik të jetë pjesë e licencës së kompanisë. Përkundrazi lejonet që përgjegjësi teknik të jetë edhe drejtues i kompanisë. Ndërsa për subjektet që tregëtojnë produkte pra mjete ato nuk parashikohen në ligjin e posaçëm sektorial të kenë përgjegjës teknik dhe për më tepër që të kenë drejtues teknik sikundër e kërkon AK dhe jo më të ketë drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

Pra AK me veprime konkludente të drejtpërdrejta ka tejkaluar diskrecionin dhe ka ushtruar në mënyrë disproporcionale çfardo nevojë të diktojnë llojin e kontratës. Pra AK kërkon mjete dhe nuk ka parashikuar në DT asnjë aktivitet shërbimi. Madje edhe periudha e garancisë është aq minimaliste sa që nuk ka nevojë për shërbim mirëmbajtje. Pra periudha 3 mujore është e papërfillshme me çfardollos nevojë ti dalë AK në zbatimin e kontratës. Referuar praktikave tregëtare në vendin tonë madje edhe sipas të dhënave të vetë INSTAT njësitet ekonomike që tregëtojnë mjete janë vecmas nga ato të autoriparimit pasi kanë të bëjnë me aktivitetet tregëtare tërësisht të ndryshme në formë dhe në përmbajtje.

Kërkojmë nga AK të heqë këtë kërkesë ose të riformulojë sa më pranë kushteve të tregut kërkesën dhe të heqë automatikisht kërkesën që subjekti të ketë përgjegjës mekanik apo teknik të regjistruar në licencën e kompanisë. Neni 6 parashikon dokumentacionin që duhet të ketë

përgjegjësi teknik si kontrata e punës dëshmia apo diploma”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar ing Mekanik staf teknik, te perfshire ne licensen e shoqerise i paisur me deshmi aftesi profesionale leshuar nga Ministria Transportit dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2019-Janar 2020 për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listëpagesat e shoqërisë, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur.*

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Kamioncine Veteshkarkuese (Mbrapa Majtas Djathtas)

<i>Viti I prodhimit</i>	<i>Jo me te vjeter se Viti 2013</i>
<i>Kilometra te pershkruara</i>	<i>Jo me shume se 130.000</i>
<i>Nr I vendeve</i>	<i>5+1</i>
<i>Nr I Dyerve</i>	<i>3 deri 4</i>
<i>Pesha e autorizuar</i>	<i>2900-3400 Kg</i>
<i>Pesha mbajttese</i>	<i>800-1000 Kg</i>
<i>Cilindra</i>	<i>Jo me pak se 4</i>
<i>Fuqia KË</i>	<i>90-110</i>
<i>Karburanti</i>	<i>Nafte</i>
<i>Depozita</i>	<i>60-80Litra</i>
<i>Emetimi I gazrave</i>	<i>Min Euro 5</i>
<i>Trasmisioni</i>	<i>4x2</i>
<i>Nr I gomave</i>	<i>4-6</i>
<i>Gjtaesia e mjetit</i>	<i>500-600 cm</i>
<i>Gjeresia e mjetit</i>	<i>190-210 cm</i>
<i>Lartesia e karocerise</i>	<i>35-40 cm</i>
<i>Sistemi</i>	
<i>Timoni</i>	<i>Hidraulik</i>
	<i>ABS</i>
	<i>AIRBAG</i>

Auto Kulle (Platforme Pune)

<i>Viti I prodhimit</i>	<i>Jo me e vjeter se 2011</i>
<i>Kilometra</i>	<i>Jo me shume se 130.000</i>
<i>Ore pune</i>	<i>Jo me shume se 600 orë</i>
<i>Nr I vendeve</i>	<i>2+1</i>
<i>Nr I dyerve</i>	<i>2</i>
<i>Pesha max e autorizuar</i>	<i>3400-3600Kg</i>

<i>Nr I cilindrave</i>	4-6
<i>Fuqia KË</i>	80-100
<i>Gjatesia</i>	450-500cm
<i>Gjeresia</i>	<i>Jo me shume se 190cm se bashku me kembet mbajtese te hapura</i>
<i>Lartesia</i>	250-270cm
<i>Kendi Rutullimit te Platformes</i>	<i>Jo me pak se 360 grade</i>
<i>Emetimi I gazrave</i>	<i>Min euro 5</i>
<i>Gjatesia e platformrs vertikalisht</i>	<i>Jo me pak se 8metra</i>
<i>Gjatesiae platforms ne pune</i>	<i>Jo me pak se 10 metra</i>
<i>Gjatesia e hapjes anesore</i>	<i>Jo me pak se 6 metra</i>
<i>Pesha mbajtese e koshit</i>	<i>Jo me pak se 200 Kg</i>
<i>Sistemi</i>	
<i>Timoni</i>	<i>Hidraulik</i>
	<i>ABS</i>
	<i>AIRBAG</i>

III.1.3. Në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sasia e mallit që kërkohet:

<i>Pershkrimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
<i>Kamioncine Veteshkarkuese (Mbrapa Majtas Djathtas)</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>
<i>Auto Kulle (Platforme Pune)</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>

Afatet e lëvrimit: 10 ditë nga data e lidhjes se kontrates

III.1.4. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me kriterin sa më lart argumentohet si vijon: *OE Luar Bros ka cituar ligjin 9573 dtaë 03.07.2006 i ndryshuar me ligjin 10137 datë 11.05.2009. Theksojmë se konkretisht neni 2/1 përcakton qartazi veprimtaritë e neneve 3 dhe 12 përkatëisht autoriparimi dhe shiblerja e mjeteve ku ndër të tjera thuhet se subjektet që kanë të përcaktuara veprimtaritë në nenin 3 dhe 12 të këtij ligji duhet të jenë të pajisura me licencë VII.3. Është detyrim ligjor që shoqëritë që merren me veprimtaritë që rregullohen nga ligji i sipërcituar të jenë të pajisura me licencën VII.3. dhe të kenë një përgjegjës teknik i cili duhet të jetë i pajisur me DAP (dëshmi aftësie profesionale të veprimtarisë së autoriparimit ku DPSHTRR ka përgatitur gjithë infrastrukturën e nevojshme me DAP në plotësim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.9573*

datë 03.07.2006 i ndryshuar, Udhëzimi nr.1564 datë 29.03.2016 për Autoriparimin, Rregullore nr.4 datë 21.04.2018 DPSHTRR. Për tu pajisur me DAP në përputhje me përcaktimet në ligjin nr.9573 datë 03.07.2006 aplikanti duhet të jetë inxhinier mekanik. AK ka kërkuar tek kriteret e vecanta specifike që lidhen ngushtë me natyrën e shërbimit dhe që janë në përpjestim me objektin e kontratës që do prkurohet.

Duke qënë se AK kërkon të blejë mall në procedurën e prokurimit në fjalë Mjete transporti dhe agregat është e domosdoshme për AK të njohë kapacitetet teknike të OE që do të garojë në tender vetëm në këtë mënyrë AK arrin të vërtetojë aftësinë reale teknike të OE për të përmbushur kontratën në mënyrë të saktë sipas kërkesave të AK. Aq më tepër në momentin që kemi të bëjmë me mjete transporti të përdorura për të cilat kërkohet garanci teknike 3 mujore, vërtetimi nga një ing mekanik i licensuar që këto mjete janë në standartet e kërkuara nga AK bëhet i domosdoshëm. AK ka kërkuar një periudhë 3 mujore garancie ku parashikohet autoriparimi dhe gjithashtu çfarë është më e rëndësishme kërkon që mjetet të jenë në standartin e kërkuar, të jenë në gjendje shumë të mirë pune dhe për këtë është shumë i domosdoshëm certifikimi i cilësisë së mjeteve në ing Mekanik i licensuar. Pra kërkesa e AK nuk ka lidhje vetëm me autoriparime (mëse të domosdoshme) dhe kategori ligjore të ndërlidhura ashtu sic pretendon OE Luar Bros pasi në mundësinë më të keqe ku mjetet mund të kenë ndonjë problem teknik gjatë periudhës 3 mujore të garancisë AK e ka cituar në mënyrë të qartë tek kriteret teknike në pikën 8 ku citohet se OE duhet të ketë kontratë qeraje me një servis të specializuar për riparime mjetesh. Rrjdhimisht pretendimi i ankimuesit nuk pranohet.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkuluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.1.7. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se kriteri lidhur me *Ing Mekanik staf teknik, te perfs hire ne licensen e shoqerise i paisur me deshmi aftesi profesionale leshuar nga Ministria Transportit dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhen Gusht 2019-Janar 2020 për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listëpagesat e shoqërisë, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur*, është jo në proporcion me natyrën e kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkret autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë mall, që ka të bëjë me mjete transporti dhe agregate cka do të thotë që jemi përpara një kontrate furnizimi e cila referuar specifikimeve teknike nuk ka element vendosje instalimi, riparimi apo ndonjë element sado të vogël shërbimi që të justifikojë vendosjen e kapaciteteve profesionale sikundër është vendosur në rastin konkret.

Gjithashtu referuar argumentave të sjella nga autoriteti kontraktor lidhur me justifikimin e vendosjes së këtij kriteri, KPP konstaton se autoriteti kontraktor e ka lidhur nevojën e vendosjes së kriterit me me kategorinë e licencës VII.3 që sipas autoritetit kontraktor duhet të disponohet nga operatorët ekonomikë që operojnë në fushën e autoriparimit dhe shitblerjes së mjeteve. Lidhur me këtë argument KPP vëren se në asnjë pikë të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk rezulton të jetë kërkuar disponimi nga operatorët ekonomikë të licencës VII.3. Në këtë kuptim KPP gjykon se derisa nuk është e nevojshme disponimi i licencës nuk ka asnjë arsye të kërkohej ing mekanik i cili të figurojë në licencën e shoqërisë.

Gjithashtu nevojën e vendosjes së kriterit sa më sipër, autoriteti kontraktor e ka argumentuar edhe me faktin se kemi të bëjmë me mjete transporti të përdorura për të cilat kërkohej garanci teknike 3 mujore. KPP gjykon se argumentat e autoritetit kontraktor nuk qëndrojnë për faktin se jemi përpara një kontrate furnizimi e cila nuk përmban asnjë element shërbimi. Periudha e garancisë nënkupton që subjekti që ka kryer një furnizim të përgjigjet brenda periudhës së garancisë për çdo defekt të mundshëm të mallit dhe marrjen përsipër të ndërimit apo rregullimit të saj por kjo nuk lidhet me ndonjë kapacitet profesional që duhet ta disponojë patjetër operatori ekonomik pasi kjo nuk lidhet aspak me natyrën e kontratës objekt prokurimi. Për më tepër që autoriteti kontraktor në kriterin tjetër të kualifikimit ka parashikuar mundësinë e operatorit ekonomik të paraqesë një kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë.

III.1.8. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: 2. *Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe*

efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; 13 d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kriterit lidhur me disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një ing mekanik i cili të figurojë në licencën e shoqërisë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” shpk për modifikimin e kriterit “Në lidhje me kërkesën e AK: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht, 1(një) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për periudhen Gusht 2019-Janar 2020.

Vlerësojmë se kjo kërkesë nuk ka asnjë bazë me kërkesat e AK në DT si dhe nenit 12 të ligjit të sipërcituar. Kërkesa është disproporcionale dhe nuk ka lidhje me objektin e kontratës, kjo për faktin se automakinisti është manovrator dhe AK nuk ka kërkuar shërbim automekanik, por ka kërkuar blerjen e një mjeti motorrik. AK nuk ka parashikuar asnjë shërbim që lidhet me automekaniken duke e bërë këtë kërkesë të ekzagjeruar, irracionale dhe të paligjshme. Ajo bie ndesh me nene të ligjit për autoriparimin, shitblerjen e mjeteve motorrike, e cila parashikon disa kategori të ndryshme subjektësh që operojnë në fushën e autoriparimit, tregëtimit, ndërmjetësimit të mjeteve të reja e të përdorura dhe nuk parashikon në asnjë moment që subjekti tregëtar të ketë cdo lloj punonjësi teknik. Pra shitblerja ndryshon nga shërbimet por AK duhet të sensibilizohet të jetë më i ligjshëm në veprimtarinë e tij administrative. Ndaj sa më sipër kërkojmë heqjen e këtij kriteri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht, 1(një) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për periudhen Gusht 2019-Janar 2020.*

III.2.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- **Kamioncine Veteshkarkuese (Mbrapa Majtas Djathtas)**
- Viti I prodhimit *Jo me te vjeter se Viti 2013*
- Kilometra te pershkruara *Jo me shume se 130.000*
- Nr I vendeve *5+1*
- Nr I Dyerve *3 deri 4*
- Pesha e autorizuar *2900-3400 Kg*
- Pesha mbajtese *800-1000 Kg*
- Cilindra *Jo me pak se 4*
- Fuqia KË *90-110*
- Karburanti *Nafte*
- Depozita *60-80Litra*
- Emetimi I gazrave *Min Euro 5*
- Trasmisioni *4x2*
- Nr I gomave *4-6*
- Gjatesia e mjetit *500-600 cm*
- Gjeresia e mjetit *190-210 cm*
- Lartesia e karocerise *35-40 cm*
- Sistemi
- Timoni *Hidraulik*
- *ABS*
- *AIRBAG*
-
- **Auto Kulle (Platforme Pune)**
- Viti I prodhimit *Jo me e vjeter se 2011*
- Kilometra *Jo me shume se 130.000*
- Ore pune *Jo me shume se 600 orë*
- Nr I vendeve *2+1*
- Nr I dyerve *2*
- Pesha max e autorizuar *3400-3600Kg*
-
- Nr I cilindrave *4-6*
- Fuqia KË *80-100*
- Gjatesia *450-500cm*
- Gjeresia *Jo me shume se 190cm se*
- bashku *me kembet mbajtese te*
- hapura
- Lartesia *250-270cm*
- Kendi Rutullimit te Platformes *Jo me pak se 360 grade*
- Emetimi I gazrave *Min euro 5*
- Gjatesia e platformrs vertikalisht *Jo me pak se 8metra*
- Gjatesiae platforms ne pune *Jo me pak se 10 metra*
- Gjatesia e hapjes anesore *Jo me pak se 6 metra*
- Pesha mbajtese e koshit *Jo me pak se 200 Kg*

- Sistemi
- Timoni Hidraulik
- ABS
- AIRBAG

III.2.3. Në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- **Sasia e mallit që kërkohet:**

<i>Pershkrimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
<i>Kamioncine Veteshkarkuese (Mbrapa Majtas Djathtas)</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>
<i>Auto Kulle (Platforme Pune)</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>

- **Afatet e lëvrimit: 10 ditë nga data e lidhjes se kontrates**

III.2.4. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me justifikimin e vendosjes së kriterit sa më sipër argumentohet si vijon: *Përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit me rrota gome (ku bëjnë pjesë autokullat) përpara se të marin DAP duhet të jenë të pajisur detyrimisht edhe me leje drejtimi të lëshuar nga DPSHTRR-ja konform nenit 122 të ligjit nr.9378 dt 22.07.1998 Kodi Rrugor i RSH të ndryshuar. Kërkesa e AK në pikën 6 lidhet në mënyrë të ngushtë me kërkesën e AK në pikën 9, më specifikuisht nevoja për një automakinist shpjegohet me faktin se nisur nga fakti se AK kërkon që mjetet e dorëzuara të jenë të targuara në emër të AK si dhe duke marrë parasysh afatin 10 ditor të dorëzimit përcaktuar në realizimin e kësaj kontrate duhet të dëshmojë se disponon të gjithë kapacitetin teknik të kërkuar konkretisht 1 automakinist i cili shërben për të qarkulluar autokullën. Pra deri në dorëzimin e mallit pranë AK ka disa hapa ku vetë OE do i duhet të qarkullojë me mjetin autokullë ku do të plotësohen disa kushte ku përvec targimit do të kryhet si kontrolli fizik ashtu dhe kontrolli teknik.*

III.2.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin*

e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.2.7. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se kërkesa e vendosur nga autoriteti kontraktor për kontratën objekt prokurimi është e tepërt, diskriminuese, jo në përputhje me natyrën e kontratës. Në rastin konkret jemi para një kontrate që ka për objekt vetëm furinzhimin me mallra pa asnjë element shërbimi, instalimi, vendosje, riparimi etj mungesa e të cilave e bën tërësisht të panevojshme kërkesën e autoritetit kontraktor për një automkinist. Gjithashtu të paargumentuar e gjen Komisioni vendimin e KSHA lidhur me nevojën e vendosjes së kriterit e cila lidhet me elementë të paparashikuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të tregohet proporcional dhe i arsyeshëm në vendosjen e kriterëve kualifikues dhe të ketë parasysh natyrën e kontratës. Kërkesa për kapacitetet profesionale të tilla si automkinist janë tërësisht të panevojshme dhe kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre vetëm tregëtimin dhe shitjen e mallrave sikundër është dhe objekti konkret i prokurimit. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: 2. *Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; 13 d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit*

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kriterit të vecantë të kualifikimit lidhur me automakinistin nga dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” shpk për modifikimin e kriterit *Operatori ekonomik duhet të ketë marreveshje ose kontrate me shitësin ose distributorin të Autorizuar të shoqëruar me specifikime teknike të mjeteve dhe Foto, në rast se kontrata ose marreveshja është me shitës ose distributore të huaj duhet të jete e perkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Automjetet duhet të jene të prodhuara në Komunitetin Europian.*

Kërkojmë riformulimin e tij pasi kjo kërkesë nuk mban parasysht të drjetën e ndërmjetësve për të ofruar shërbime referuar nenit 14 të këtij ligji. Pika 3 e nenit 14 sanksionon vetëm këtë kërkesë në lidhje me subjektet ndërmjetësuese. Subjektet e lartpërmendura duhet të mbajnë në mjediset ku ushtrojnë veprimtarinë, në vende të dukshme, tabelat e veprimeve që kryejnë, si dhe tarifatat përkatëse për çdo ndërhyrje të bërë. Në të kundërt u nënshtrohen sanksioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

Pra sic del qartë referuar kërkesave të këtij ligji subjektet që merren me shitblerje apo ndërmjetësim nuk kanë asnjë detyrim por trajtohen vecmas nga entet ekonomike të autoriparimit. Ndaj tyre nuk parashikohet asnjë kërkesë apo staf teknik përveç detyrimeve administrative për mirëmbajtjen e të dhënave regjistruar etj.

Kjo kërkesë vjen në kontraditë me kërkesën e pikës 1 të KVK e cila kërkon: Operatori ekonomik duhet të deklarojë llojin e mjeteve, të shoqëruara me librezën përkatëse dhe me foto për secilin, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjeteve me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen edhe kilometrat e bëra për çdo mjet, të shoqëruar edhe me foto të treguesit të kilometrazhit në kroskot për secilin prej tyre.

Vjen në kontraditë pasi disa subjekte mund të zotërojnë mjetet dhe ato nuk parashikohen në këtë kërkesë. Vjen në kontraditë me kërkesën e AK që OE të paraqesin ofertë për mjetin shoqëruar me librezën si dhe me deklaratë garancie. Pra nuk krijohet lidhja logjike dhe ligjore ndërmjet posedimit të sendit dhe posedimit të dokumentave. Ndërkohë ndërmjetsi mund të posedojë proformat që janë parakontrata me faturë parapagese dhe nuk posedojnë dokumenta të tjera dhe operojnë në përputhje me nenin 14 të këtij ligji. Pra AK e ka kufizuar veprimtarinë e OE garues vetëm tek operatorët e autoriparimit dhe kanë lënë jashtë shitblerjen dhe negociimin pra OE që shesin dhe ndërmjetësojnë shitblerjen e tyre. Në asnjë rast ligji nuk e kushtëzon veprimtarinë e tyre me autorizim prodhuesi apo kontratë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.3.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.8 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të ketë marreveshje ose kontrate me shitësin ose distributorin të Autorizuar të shoqëruar me specifikime teknike të mjeteve dhe Foto, në rast se kontrata ose marreveshja është me shitës ose distributore të huaj duhet të jetë e perkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Automjetet duhet të jenë të prodhuara në Komunitetin Europian.*

III.3.3. Në nenin 27, pika 6, e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.3.4. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me kriterin sa më lart argumentohet si vijon: *AK nuk ka kërkuar të limitojë ofertat e OE konkurrues në tender. Kjo pasi AK i ka dhënë mundësinë OE garues të paraqesin ose marrëveshje me shitësin ose kontratë*

me shitësin ose marrëveshje me distributorin e autorizuar ose marrëveshje me distributorë të huaj ose marrëveshje me shitës të huaj. Pra një gamë e gjërë mundësisish për paraqitje dokumentacioni që në asnjë mënyrë nuk limitojnë apo kufizojnë OE të interesuar për të paraqitur oferta. Është e bazuar në ligj dhe tejet llogjike rëndësia për AK që OE të ofertojë mallin me specifikimet teknike të kërkuara në këtë procedurë prokurimi. OE Luar Bros ka përmendur edhe Incoterms (ICC) si dhe proforma invoice CNF. Duke parashtruar faktin se procedurat e prokurimeve publike në RSH rregullohen nga LPP dhe jo nga normat ndërkombëtare të ligjit tregëtar ndërkombëtar theksojmë se proforma invoice CNF në asnjë mënyrë nuk kushtëzon OE të interesuar nga ofertimi pasi proforma invoice CNF nuk do të thotë që OE i interesuar mos të mundësojë 1) përshkrimin e mallit, 2) informacion teknik të mallit, 3) informacion të shoqëruar me të dhënat teknike dhe foto. Ankesa nuk pranohet.

III.3.5. Referuar kriterit sa më sipër KPP e gjen atë në përputhje me dispozitat ligjore, proporcional me objektin dhe në përputhje me natyrën e kontratës. Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të zotërojnë marrëveshje ose kontrate me shitësin ose distributorin e autorizuar të shoqëruar me specifikime teknike të mjeteve dhe foto, në rast se kontrata ose marrëveshja është me shitës ose distributore të huaj duhet të jetë e perkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. KPP gjkon se autoriteti kontraktor brenda kuadrit ligjor ka kërkuar dëshmi mbi origjinën e mallit në mënyrë që të krijojë bindjen mbi cilësinë e mallit të ofruar dhe përputhjen e tij me specifikimet teknike. Në kuadër të saj ka kërkuar foto të mjetit dhe të jenë të shoqëruara me specifikimet teknike. KPP e gjen të drejtë argumentin e autoritetit kontraktor lidhur me nevojën e vendosjes së këtij kriteri e cila lidhet me garancinë mbi cilësinë dhe origjinën e mallit objekt prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.6. Lidhur me pretendimet e tjera të ankimuesit sa i takon vendosjes si alternativës së ndërmjetësimi si dhe detyrimi i autoritetit kontraktor për reference tek incotermet, KPP i gjen pretendime evasive të paqarta të pargmentuara e që nuk kanë lidhje me kriterin e ankimuar. Për më tepër, KPP gjkon se në rastin konkret operatori ekonomik ankimues nuk kundërshton një vendim të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjkon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, përse kohë që autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar vendosjen e alternativës së ndërmjetësimi apo akoma më tej incotermet, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret e tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimet e ankimesit nuk qëndrojnë.

III.4. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik tërheq vëmendjen e autoritetit kontraktor pasi nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se në datën 28.02.2020 ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Hapjen dhe Vlerësimin e Ofertave” në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik lidhur me respektimin e afteve procedurale të ankimit. Rezultoni se operatori ekonomik “Luar Bros” shpik pas publikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afateve ligjore pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në KPP.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* Në nenin 63 pika 3 e lex specialis, LPP parashikohet se *“ Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.”* Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e lex specialis i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se *“ [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”*.

Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkelur afatet procedurale të ankimi duke vijuar me “Hapjen e Ofertave“ dhe “Vlerësimin e Ofertave” brenda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimes i lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në një shkallë më të lartë ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së.

III.4.1. Në nenin 31, pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet se: *“[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me*

akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-49029-02-04-2020, me objekt “*Blerje Mjete transporti dhe agregat*”, me fond limit 12 500 000 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 28.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, me rishpalljen e procedurës së prokurimit, të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 217 Protokolli; Datë 24.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

